

Shpalosje e afarizmit
vjetor të
KRU "Radoniqi" Sh.A.

Raporti vjetor 2009

Të ruajmë dhe mbajmë cilësinë e ujit edhe për gjeneratat e ardhshme



Përmbajtja:

Për KRU "Radoniqi" –Sh.A.	3
Rregullatori dhe organizimi	4
Fjala e Drejtorit Ekzekutiv si hyrje	5
Fjala e Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve	7
Piksynimet tona kryesore	9
Konsumatorët tanë	10
Resurset njerëzor	11
Infrastruktura jonë O&M	13
Shërbimi për Konsumatorë	15
Pasqyrat e progresit financiar	17

Drejt sfidave të reja

KRU “Radoniqi” Sh.A.

Synimet tona

KRU “Radoniqi”-Sh.A. ka për synim furnizim të qëndrueshëm me ujë të pijshëm dhe cilësor, shërbime të efektshme me përkujdesje mjedisore si dhe të kërkojmë donacione për projektet rimëkëmbëse:

- T’u ofrojmë konsumatorëve shërbime të mira dhe t’i bindim ata për pagesën e fakturave
- Ta ruajmë dhe përmirsojmë mjedisin gjithandej ku veprojmë
- T’u mundësojmë punëtorëve tanë zhvillim personal dhe karrierë të kënaqshme
- T’i bindim donatorët që investimet e tyre do të jenë të shpagueshme

Vlerat tona

Ne jemi të përsosur vetëm me kontributin e secilit prej nesh, punë me vlera dhe aftësi ekipore

Ne jemi të ndershëm në kryerjen e shërbimeve tona

Ne trajtojmë me respekt njëri-tjetrin, konsumatorët dhe mjedisin ku veprohet

Fakte dhe shifra

KRU “Radoniqi”-i furnizon me ujë të pijshëm rreth 230.000 banor, me rreth 50.000 m³/ditë

Ne kemi:

- Kaptaxhën në lumin Bistrica të Deçanit
- Kanalin derivues prej 7km
- Liqenin e Radoniqit si vetmi burim
- Stacionin e filtrave për trajtimin e ujit
- 15 rezervuare të ujit
- 10 stacione pompimi
- 520 km rrjet kryesor

Përveq furnizimit me ujë të pijshëm

KRU “Radoniqi” bënë shërbime për

Largimin e ujrave të përdorura me:

- 56 km rrjet kanalizimi
- 1250 puseta



Regjioni i furnizimit me shërbime nga KRU “Radoniqi”

Rregullatori dhe organizimi

Në mbështetje të Nenit 92, paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Nenit 15 të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike, si dhe të Nenit 4, paragrafi (3) të Rrgullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Kosovës pas një procedure të hapur, transparente dhe konkurruese, ekskluzivisht në bazë të meritave, për KRU “Radoniqin” Sh.A.-Gjakovë më datë 24.12.2008 merr vendimin nr. 17/48 mbi formimin e Bordit të Drejtorëve në këtë përbërje:


- 1) z. Ruzhdi Këpuska, kryesues i Bordit të Drejtorëve
- 2) z. Agim Gjoshi, anëtar
- 3) z. Hajdar Grezda, anëtar dhe
- 4) z. Leonard Shehu, anëtar

Bordi i Drejtorëve:

Bordi i Drejtorëve që nga fillimi i punës së tyre ushtron në vazhdimësi veprimtarinë e rritjes afatgjate të vlerës së ndërmarrjes dhe aksioneve. Ushtron kontroll të vazhdueshëm mbi Kryeshefin Ekzekutiv dhe mbi zyrtarët tjerë të Kompanisë në zbatimin e politikave afariste të ndërmarrjes. Si organ më i lartë i Kompanisë, përbëhet nga katër (4) Drejtor jo Ekzekutiv dhe një Drejtor Ekzekutiv, i cili njëherit është edhe Kryeshefi Ekzekutiv i Ndërmarrjes me të drejtë vote në vendimmarrje.

Drejtori Ekzekutiv:

Është Kryeshef Ekzekutiv i Kompanisë, i cili zbaton politikat afariste të Ndërmarrjes me ekzekutimin e vendimeve të Bordit të Drejtorëve, komform Statutit dhe Akteve nënligjore të Kompanisë si dhe menaxhimin e punëve të përditshme dhe detyrave të punës në Kompani. Struktura Menaxhuese mbrenda kompanis është e përcaktuar në bazë të Statutit të Kompanisë, e që fillon me majen hierarkike, me Kryeshefin Ekzekutiv, pastaj Shefi i Financave, Sekretari si dhe Auditori i Mbrendhëm.



Fjala dhe mesazhi i kryeshefit ekzekutiv:

I nderuar z. Kryetar dhe Anëtar të Bordit të Drejtorëve

Kam kënaqësinë të raportojë rezultate konkrete, të cilat K.R.U. “Radoniqi” SH.A. Gjakovë i arriti falë një strategjie të qartë dhe një ekzekutivi të përkushtuar, dinamik si dhe një personeli të vyer, me të cilët arriti të përmbushë objektivat e përcaktuara nga Bordi i Drejtorëve dhe Aksionari i ynë. Më lejoni që në këtë fjalë hyrëse të jap disa të dhëna themelore, duke qenë i bindur se në Raport janë dhënë deri në detaje të gjitha të dhënat relevante, që e dëshirojnë këtë aktivitet të suksesshëm afarist të Kompanisë sonë. Do të përqendrohem në të dhëna të përgjithshme për K.R.U. “Radoniqi” SH.A. Gjakovë.

Kam kënaqësinë dhe nderin që para së gjithash, të falënderojë dhe t’u jem shumë mirënjohës Zyrës së Njësisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike për përkrahje në të gjitha sferat e funksionimit të Kompanisë, e posaçërisht për ndarjen e Donacioneve nga Buxheti Qeveritar që është bazë qëndrueshmërie dhe efikasiteti për KRU “Radoniqi” SH.A. Gjakovë. Ju faleminderit!

Duke pasur parasysh shumë obligime të shtuara për shpenzime, të cilat nuk i kishte ngarkesë Kompania e jonë në të kaluarën e afërt që është paraqit në vitin 2009, si p.sh. pagesa e furnizimit me kemikale në shumë prej 39.660.⁰⁰ € obligim ky që paguhej më parë nga AKM.

Pastaj u obliguam nga Sindikata e punëtorëve, që të bëjmë pagesën e shujtës së punëtorëve ashtu si të gjitha Kompanitë tjera të ngjashme të Republikës së Kosovës, e që kjo ishte kosto në vlerë prej 115.692.⁰⁰€, si dhe shlyerja e obligimeve e borxhit të akumuluar që nga viti 2002, me saldo 31.12.2008 në vlerë prej 50.000.⁰⁰ € në emër të TVSH -së ndaj ATK -së, vlerë kjo që shtohet në vazhdimësi me kamata ndëshkuese. Pra duke pasur parasysh këto të dhëna, obligime të jashtëzakonshme, të paguara nga Kompania gjatë vitit 2009, nënkupton, një vit afaristë që përmbyllim me një fitim financiar edhe pse kishim parasysh realitetin e një situatë jo të mirë ekonomike dhe aspak të qëndrueshme të popullatës së këtij regjioni.



z. Albert Zajmi - Kryeshef ekzekutiv

Pra duke pasur parasysh këto të dhëna, obligime të jashtëzakonshme, të paguara nga Kompania gjatë vitit 2009, nënkupton, një vit afaristë që përmbyllim me një fitim financiar edhe pse kishim parasysh realitetin e një situatë jo të mirë ekonomike dhe aspak të qëndrueshme të popullatës së këtij regjioni.

Ne megjithatë arritëm të përmbyllim vitin me një fitim të konsiderueshëm financiar, edhe pse si të hyra në arkë krahasuar me vitin 2008, ishim minus 10.000.⁰⁰€, pra përkundrajt të gjitha obligimeve të shtuara dhe të imponuara, por dhe të paguara nga Kompania, të cekura më lartë, në të kundërtën do të ishim profitabil për 193,596.00 €, duke u bazuar në pagesat e akumuluar, Kompania del me humbje minus 11,756.00 €.

Këtë e kemi arritur ta bëjmë falë aktiviteteve shtesë bashkëpunimi me Publikun dhe Konsumatorin, duke i njoftuar ata vazhdimisht, por edhe duke dëgjuar zërin e tyre. Këtë e kemi arritur me një organizim të mirë të punës dhe me një motivim të mirë të stafit.

Në fund të vitit 2009 K.R.U. “ Radoniqi “ SH.A. Gjakovë kishte gjithsejtë të punësuar 217, prej të cilëve 209 me kontratë me kohë të pacaktuar dhe me 7 me kontratë me kohë të pacaktuar dhe 1 me kontratë mbi vepër .

K.R.U. “ Radoniqi “ SH.A. Gjakovë ka investuar shumë kohë dhe mjete në trajnimin e vazhdueshëm të stafit të vet, duke ngritur kështu performancaën e tyre dhe të tërë Kompanisë .

K.R.U. “ Radoniqi “ SH.A. Gjakovë gjithashtu ka shënuar suksese të rëndësishme në ofrimin e shërbimeve kualitative , të kapshme dhe shumë produktive .

Në vazhdimësi jemi dhe ishim të gatshëm të bëjmë shtrirjen dhe renovimin e rrjetës së vjetër dhe këtë e dëshmuam me disa raste si në Komunën e Prizrenit , Komunën e Rahovecit dhe Komunën e Gjakovës.

Më lejoni për fund , që të mos i përsëris më tej të dhënat , të cilat do t’i gjeni në Raportin Vjetor, të përcjelli një falënderim të singertë në emër të Anëtarëve të Menaxhmentit të K.R.U. “ Radoniqi “ SH.A. Gjakovë, për gjithë punonjësit e vyeshëm të Kompanisë dhe të gjithë ata që me bashkëpunimin dhe me angazhimin e tyre kontribuan në përmbylljen me sukses të këtij viti , duke hapur kështu rrugët edhe për ndryshime më të mëdha, pozitive që u filluan në 2010.

Posaçërisht falënderojë Bordin e Drejtorëve të K.R.U.“ Radoniqi “ SH.A. Gjakovë për përkrahje të vazhdueshme dhe inkurajuese për projektet dhe përkrahjen e Menaxhmentit të K.R.U. “ Radoniqi “ SH.A. Gjakovë. Falënderojmë edhe partnerët tanë afaristë, që pa bashkëpunimin reciprok në mes kompanive tona, nuk do të kishim mundur të përmbyllim këtë vit suksesesh. Mbi të gjitha më lejoni të shpreh mirënjohje dhe respekt për madhërinë e tij - Konsumatorin tonë besnik , i cili na beson dhe i pëlqen produkti i jonë , ujë me cilësi, sasi dhe shtypje të mjaftueshme, me furnizim 24 orësh , e që shpresojmë të kenë begatuar dhe lehtësuar shumë nevojat e përditshme dhe jetën e tyre në përgjithësi .

Për fund falënderoj Zyrën e Njesisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, dhe gjithë ata që me sygjerimet e tyre na mundësuan të jemi më të mirë, të gjithë ata që me fjalët e mira na dhanë zemër të besojmë se ne me punën tonë jemi tashmë një faktorë i veçantë , i cili bënë që qytetarët tonë të përmbushin me efikasitet nevojat tona të domosdoshme për funksionimin në vazhdimësi të Kompanisë sonë, si Kompani e vetë financiar, që funksionojmë me çmime të pranueshme dhe me kualitet të lartë.

Me respekt: z. Albert Zajmi

Kryeshefi Ekzekutiv
K.R.U. “ Radoniqi “ SH.A. Gjakovë

Fjala dhe mesazhi i kryeshefit ekzekutiv:

I nderuar aksionar

Kam kënaqësinë të raportoju edhe për një vit aktivitete të vështira por të suksesshme të kompanisë tonë, e cila falë angazhimit të përgjithshëm të Menaxhmentit dhe punonjësve të vet, vazhdon të jetë kompani e vetme që furnizon me ujë të pijes banorët e KK Gjakovës,

KK Rahovecit dhe një pjesë të fshatrave të Prizrenit.

I furnizojmë rreth 230.000 qytetarë me ujë **i cili është edhe jetë.**

Për të menaxhuar me ujin që është edhe jetë është vështirë aq më shumë në këto kushte kur shumë qytetarë kanë vështirësi ekonomike, jetojnë me ndihma sociale por ka edhe shumë biznese dhe disa institucione të cilat nuk paguajnë ujin e shpenzuar.

Të orientuar plotësisht kah konsumatori e përgjegjësisht me të cilën komunikojmë çdo çast për tërë vitin ia kemi dalë që kompania në këtë vit të ketë një sukses shumë të mirë me furnizim të ujit të qytetarëve si dhe me një sukses të kënaqshëm financiar.

Siç e dini kompania jonë menaxhon kaptazhën, kanalin derivues, liqenin e Radoniqit, stacionin e filtrave, rezervuar, stacione pompash si dhe 520 km rrjetë të ujësjellësit dhe 100 km rrjetë të kanalizimit.

Në bashkëpunim me institucionet e vendit e në veçanti me Qeverinë e Kosovës ne kemi zhvilluar një strategji të mirë që i përshtatet kushteve ekonomike dhe rrethanave aktuale të shoqërisë.

Kemi krijuar bashkëpunim të mirë me punëtorët, sindikatën për përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të punës dhe standardin e punëtorëve.

Kemi njoftuar publikun dhe institucionet në mënyrë të vazhdueshme dhe transparente për punën që kemi bërë si dhe për problemet që kemi patur, për problemet të cilat na presin në të ardhmen.

Kemi ndërmarrë masa që humbjet e ujit të zvogëlohen sa më shumë.

Të zvogëlojmë shpenzimet por gjithmonë duke patur parasysh që kualiteti i ujit të jetë në parametra të lartë.

Kryesisht rrjeti i ujësjellësit dhe i kanalizimit është i vjetruar. Rrjeti i ujësjellësit kryesisht është prej tubave të Asbest cementës.



z. Ruzhdi Këpuska – Kryetar i BD

Kompania jonë është përqendruar në programet përkatëse për ndërrimin e tubave aty ku rrjeti është shumë i dëmtuar, por nevojiten shumë investime që rrjetin e vjetër ta zëvendësojmë me rrjetin e ri dhe me kapacitet të duhur.

KRU “Radoniqi-Gjakovë” tashmë është ndryshe sepse kemi shtrirë përgjegjësin e bashkëpunimit nga të gjitha fushat e biznesit tonë, e në këtë kontekst edhe kemi zgjeruar me konsumatorë dhe komunitet, ku kemi arritur të mbajmë kontinuitetin e shërbimit tonë pa rritur numrin e punëtorëve.

Duke e përmbyllur këtë fjalë dhe duke iu referuar të dhënave, të cilat do të gjeni në këtë raport, kam kënaqësinë të përgëzoj të gjithë menaxherët, zyrtarët tjerë dhe punonjësit e kompanisë tone për punën e zellshme që kanë bërë.

Njëkohësisht një falënderim dhe mirënjohje e veçantë për të gjithë institucionet vendore dhe ndërkombëtare të cilat direkt apo indirekt kontribuan për suksesin tonë.

Me respekt: z. Ruzhdi Këpuska

Kryetar i Bordit të Drejtorëve
KRU “Radoniqi” Sh.A. -Gjakovë

Ne jemi krenar për
aktivitetet e sukseshme
biznesore



Pikësytimet kryesore

Gjatë gjith vitit të kaluar KRU “Radoniqi” kishte pikësytim që:

- Të ofrojmë shërbime të pandërprera për të gjithë konsumatorë
- Të përmbushim apo të tejkalojmë të gjitha nivelet e aktiviteteve të planifikuara në mirëmbajtje
- Të furnizojmë ujë cilësor dhe me efektshmëri më të mundshme mjedisore, duke i përmbushur pothuaj të gjitha në afat
- Mos kemi probleme me rezervimin e ujit në akumulacion, dhe njihërit të mos ketë nevoj për ndërprerje të furnizimit me ujë, nga ky shkak
- Të përmbushim apo edhe tejkalojmë monitorimin e të gjitha detyrave
- Të zvoglojmë humbjet e ujit
- Të mirëmbajmë funksionalitetin e mbarë infrastrukturës
- Të bëjmë investime të planifikuara dhe aty ku mundë të shfaqen e ku do të vlerësohet se mundë të vëhet në rrezik biznesi jonë
- Të planifikojmë zvoglimin e shpenzimeve për energji dhe karburante
- Të bëjmë planifikimin e investimeve vetanake tre vjeçare
- Të arrijmë të përmbushim kërkesat dhe ankesat e konsumatorëve
- Të furnizojmë shërbime cilësore dhe në kufijtë e parametrave të lejuara, sipas standardeve
- Të reduktojmë në masë të madhe rrezikun nga përmytjet nga kanalizimi fekal dhe atmosferik, gjatë periudhave me të reshura me intezitet dhe kohë të tejzgatur
- Të angazhohemi në mbrojtjen dhe sigurinë e punëtorëve tanë, dhe kjo të jetë aktivitet qenësor në vazhdimësi
- Të shtojmë kontrollin e shpenzimeve dhe të këmbëngulim për rritjen e të hyrave nga arkëtimi



Ecje me kujdes dhe siguri më të madhe për të ardhmen

Konsumatorët tanë

KRU “Radoniqi” tashmë veq ka qenë më ndryshe sepse kemi shtrirë përgjegjësin e bashkëpunimit nga të gjitha fushat e biznesit tonë, e në këtë kontekst edhe jemi u zgjeruar me konsumator dhe komunitete, ku kemi arrit të mbajmë kotinuitetin e shërbimeve, aq sa ka qenë e mundur, pa e rritur numrin e punëtorëve.

Ne kemi kontribuar në zgjerimin e hapsirës së furnizimit me shërbime për komunitetet, me të njëjtat standarde shërbyese, përmes mbikqyrjeve nga inxhinierët tanë, shërbimit të GIS-it dhe grupit të kontrollës.

Cilësia e ujit

Cilësia e ujit për furnizim i përmbushë standardet dhe i njëjti është i cilësisë së mirë dhe në nivelin më të lartë të mundshëm, ku ky nivel ishte si i viteve të mëparshme. Niveli i nitrateve në ujin e liqenit, sigurisht, është në rritje graduale, e kjo kryesisht për shkak të përdorimit të plehrave kimik në bujqësi, megjithatë ne po punojmë që cilësia e ujit të trajtuar dhe i dalur në furnizim ti plotësoj dhe përmbush me rigorizitet standardet për ujë të pijshëm. Për shembull, kur rritet prezenca e algave në liqe, në kohën e lulëzimit të tyre, ne fusim në përdorim dozuesin e karbonit aktiv i cili në masë të madhe ndihmon në përmirsimin e cilësisë së ujit. Mirëpo e gjithë kjo ka edhe anën tjetër se ndikon në uljen e prodhimit të ujit në sasi të limituara, mu për shkak të funksionalitetit të procesit flokulim-fundërrimit dhe punës së pandërerë të filtrave. Ne kemi vlerësuar se tashmë kapaciteti përpunues është në limitin mbi maksimal, dhe se me rritjen e konsumatorëve dhe zgjerimin e rrjetave furnizuese, është i domosdoshëm zgjerimi i impiatit përpunues-filtrues, e njohur tashmë si faza e dytë e stacionit të filtrave për të cilën ekziston edhe projekti qysh nga viti 1991. Nga pamundësia e implementimit të këtij projekti madhor zhvillimor afatgjatë me investime vetanake apo nga grante qeveritare (qendrore/lokale) ne kemi dhe do të vazhdojmë të kërkojmë investitor nga jasht-donator.

Por për derisa kjo nuk ndodhë, ne në programin tonë të punës për përmirsimin apo qoft ruajtjen e cilësisë

së ujit të pijshëm, e në bashkëpunim me organet përkatëse dhe komunitetin bujqësor lokal duhet ti identifikojmë ndotësit potencial dhe të përcaktohem për praktikë alternative të menaxhimit të tokës bujqësore, në mbrojtje të cilësisë së ujrave sipërfaqësore si në lumin e Bisticës së Deçanit, buzë kanalit derivues dhe poashtu në vet pellgun e liqenit të Radoniqit.

Çfarë kemi bërë ndryshe këtë vit -masat e marra në përballimin e situatave

Ne kemi ndërmarrë disa iniciativa kryesore këtë vit në përpjekje për të trajtuar problemin se disa nga konsumatorët tanë kanë të paguajnë faturat e ujit:

- Ne po bashkëpunojmë më ngushtë me MEF-in dhe ZRRUM-in në përpjekje për të shlyer borxhet e konsumatorëve duke u këshilluar për format e përpjekjeve në nxitjen e pagimit të faturave të tyre
- Ne kemi paraqitur listën e borgjlinjëve, sipas autoritetit social, të cilët kanë ndikuar në zvoglimin e arkëtimit nga konsumatorët e pandërgjegjshëm dhe nga ata që janë në vështirësi më të rëndë financiare dhe, pavarësisht përpjekjeve dhe vullnetit të tyre të mirë, ata vërtet nuk paguajnë shumën e plotë të faturave
- Ne kemi ngritur një politikë sociale nga departamenti financiar ku përmes sektoreve të marrëdhënjes me publikun, bëjmë rimbursimin e borxheve. Kjo nismë ka për qëllim të mundësojë atyre me gjendje të vështirë sociale, të paktën të bëjnë pagesa modeste.

Resurset njerëzore

Për sukseset e KRU “Radoniq”-it kontribuuan të gjithë të punësuarit. Potenciali njerëzor janë resursi më meritues në menaxhimin e biznesit tonë me plot përgjegjësi në përmbushjen e qëllimeve tona në drejtim të vetëqëndrueshmërisë së kompanisë sonë.

Rekrutimi dhe selektimi

Njësia e burimeve njerëzore në kuadër të Dep. Administrativ ,aktivitetin e saj e ka zhvilluar në realizimin e direktivave paraprakisht të përcaktuara në kuadër të këtij Dep. me rekrutimin e stafit intern dhe ekstern ,në përputhje me nevojat e parapara nga ana e njësive tjera të KRU “Radoniq”SH.A.-Gjakovë dhe në këtë drejtim janë arritur rrezultate të nevojshme ,dhe në masë janë realizuar objektivat e parapara nga njësiti e KRU.

Në kuadër të kësaj njësie gjatë kësaj periudhe është publikuar komfori nën 21.4 të Ligjit Mbi ndërmarrjet Publike konkursi për plotësimin e vendi të punës Auditor i Mbrendshëm i kompanisë.

Punët administrative

Njësia e resurseve Njerëzore – ka arritur që punët administrative, kërkesat e punëtorëve janë shqyrtuar dhe kryer shpejt dhe në mënyrë efikase. Në dep. Administrativ në kontinuitet janë përpiluar të gjitha aktivitetet e nevojshme nga marëdhënja e punës në përputhje me kërkesat e stafit të kompanisë dhe dispozitave të aplikueshme ligjore .

Është kryer një punë e veshme dhe me sukses në arkivimin dhe sistematizimin e dokumenteve të kompanisë, e tërë kjo është arritur me një organizim brenda Departamentit me caktimin e një punëtori me detyrat e përgjithshme të përgjegjës për arkiv ,i cili deri me tani ka sistemuar dhe regjistruar një numër prej 5500 dokumente zyrtare, gjë që ky person përgjegjës për një kohë të gjatë i ka munguar kompanisë që të eliminoj parregullsitë dhe kaosin që ka ekzistuar në dokumentet e vjetra zyrtare .

Struktura e stafit

Deri në fund të vitit 2009 KRU “Radoniq”

janë të evidentuar 216 punëtorë të gjithë me kontratë të rregullta dhe procedur te rregullt shpalljes publike të konkurseve .

Gjatë kësaj periudhe është bërë edhe planifikimi i stafit sipas Biznes-Planit të vitit 2009-2012 .Njësia e resurseve njerëzore ka raportuar në mënyrë të vazhdueshme për strukturën e stafit në kompani, si dhe për ndryshimet eventuale që kanë pasuar gjatë këtij viti në strukturën e stafit të Departamentit Financiar, Administrativ si dhe Teknik.

Mbrojtja në punë

Në kuadër të Dep. Administrativ në NJ. e Mbrojtjes në Punë të punëtorëve janë kryer një sërë aktivitetesh të ndryshme në fushën e mbrojtjes në punë, mbrojtjes nga zjarri në tërë Kompaninë.

Njësia për Mbrojtjen në Punë ka kryer këto punë dhe ka zhvilluar këto aktivitete ;

- Kontroll i vazhdueshmen i objekteve të ndërtesës qendrore
- Shqyrtimi i hidrantëve kundër zjarrit në të gjitha objektet
- Servisimi i aparateve kundër zjarrit në objekte dhe automjete

Njësia për çështjet ligjore

Përgjatë, dhe deri në fund të vitit 2009 nga NJ. për çështje legale në Gjykata komunale dhe ekonomike të Qarkut janë ngrit paditë për 50 persona juridik me vlerë të përafërt 400.913,70 €. Janë ushtruar parashtrësia , ankesa kundër vendimeve në Gjykatën e shkalles së parë dhe të dytë dhe revizionit.

Përfaqësuesi i kompanisë ka marrë pjesë në 35 seanca Gjyqësore si palë paditëse dhe palë e paditur. Departamenti ligjore vitit 2009 ka pas këto synime, ku edhe i ka realizuar ;

- Ofrimi i këshillave juridike për BD si dhe KE
- Mbështetja ligjore për disa projekte
- Menaxhimi i lëndëve gjyqësore
- Miratimi dhe implementimi i procedurave gjyqësore
- Hartimi i vendimeve, akteve për politikat e brendshme të kompanisë
- Ofrimin e sqarimeve juridike për çështje të caktuara që janë kërkuar nga BD

Departamenti ligjor ka kushtuar vëmendje dhe rëndësi edhe politikave të reja të miratuara nga BD, Kodi i mirësjelljes, Statutit dhe Procedurave gjyqësore.

Gjatë vitit 2009 është zhvilluar një aktivitet i gjerë në zbatimin e detyrave të marra në BD dhe plotësimin e kërkesave që kanë dalë nga autoriteti i formuar në kuadër të Qeverisë për menaxhimin dhe monitorimin e NPMNP si :

- Aprovimi i akteve (model) të dërguara nga NP
- Regjistrimi i kompanisë
- Shuarja e holdingut
- Zhvillimi i aktivitetve të përpilimit të spiraleve për NJPM me dokumentacionet nga procesverbalet dhe dokumentacionet e mbledhjeve të BD dhe KA, si dhe përpilimi i spirales për kryerjen e spirales për kryerjen e procedurave për regjistrimin e kompanisë .
- Komfor ligjit Mbi Ndermarrjet Publike është punuar në përpilimin e Organizimin dhe sistematizimit pershkrimit të detyrave të punës në kompani)

Nga Departamenti për BD është punuar në ndryshimin e Rregulloreve të brendshme të kompanisë, komfor propozimeve për ndryshime nga Komisioni i Auditimit si në :

- Rregullore Mbi Marëdhënjen në Punë të Punëtorëve
- Rregullore Mbi Ndarjen e të Ardhurave Personale

- Rregullore Mbi Përdorimin e automjeteve
- Rregullores Mbi Organizimin dhe Sistematizimin në Punë të Punëtorëve

Është zhvilluar edhe një aktivitet i ndjekjes së konsumatorëve të pandërgjegjshëm përmes gjykatës për kundërvajtje dhe prokurorisë.

Gjatë vitit 2009 në Gjykatë për Kundërvajtje janë përcjellë dhe proceduar 30 raste. Një pjesë e rasteve të lidhjeve ilegale janë ekzekutuar në kompani bazuar në Ligjin Mbi Ofruesit e Shërbimeve të ujësjetës.

Njësia e teknologjisë informative

Përgjithësisht punët në sektorin e Teknologjisë Informatike të K.R.U. RADONIQI sh.a. - Gjakovë gjatë vitit 2009 kanë shkuar mbarë. Gjatë vitit 2009 kemi pas suksese në:

- Funksionimi i sistemit në kontinuitet dhe pa ndërprerje gjatë gjithë vitit
- Publikimi i ueb faqes së kompanisë
- Implementimi i modulit të ri të kujdesit për konsumatorë
- Freskimi i sistemit me kompjuter të rinj dhe ngritja e atyre ekzistues etj.

Infrastruktura jonë - O&M

Resurset ujore (kanali derivues dhe liqeni)

Gjatë muajit Janar- Qershor 2009 ardhja e ujit nga lumi Bistrica e Deçanit ishte i volitshëm në sasi dhe cilësi, me turbiditet të ulët.

Sasia e ujit që hynte në liqe, në Janar-Shkurt ishte nga $2\text{m}^3/\text{sec}$ deri $3\text{m}^3/\text{sec}$, ndërsa në Mars-Qershor ardhja ishte edhe deri në $9\text{m}^3/\text{sec}$. Niveli i liqenit akumulues, në fund të muajit Prill arriti maksimumin dhe filloi kapërderdhja e cila zgjati 30 Prill e deri me 20 Qershor.

Nga personat të pa autorizuar është duke u shfrytëzuar uji për ujitjen e arave dhe livadheve në sasi prej 30% të sasisë së ujit të Bistricës.

Në mbushjen e liqenit kanë qenë të angazhuar grupi i 5 punëtorëve të cilit kanë qenë të angazhuar edhe gjatë natës për të menaxhuar sa më mirë mbushjen e liqenit, me këtë rast duhet cekur se ka pasur mjaft pengesa edhe nga komuniteti i fshatrave të cilët janë pranë kanalit, disa herë është kërkuar asistencë e policisë si dhe inspektoratit komunal të Deçanit por pa rezultate për përkrahje të punëtorëve të Radoniqit. Me përlogaritjet tona resurset ujore në liqe janë rimbushur rreth 70% e sasisë së tërësishme akumuluese, nëse llogariten derdhjet nga minimumi biologjik, nga KRU "Radoniqi Dukagjini" Sh.A., nga prodhimi ynë vjetorë dhe kapërderdhja. Prandaj, ne mendojmë se për këtë arsye nuk ka ndodhur fenomeni i paraqitjes së aromës së keqe nga algat.

Futja e ujit nga Bistrica në liqe është ndërprer më 01.07.2009. dhe deri në fund të vitit nuk kemi marrë fare ujë nga lumi, mu për arsye të testimi të cilësisë së ujit në liqe në parandalimin e paraqitjes së aromës së ujit nga algat, ku me këtë mund të themi se kemi pasur sukses dhe gjeri më tani nuk është paraqitur ky fenomen, me ç'rast kemi kursyer një sasi të konsiderueshme të karbonit aktiv, flokulantit, energji elektrike dhe ujë për shpëlarjen e filtrave etj

Menaxhimi i ujit në liqenin akumulues

Siq është cekur më lartë më këtë punë janë të angazhuar 5 punëtorët për kryerjen e këtyre punëve ku problemi më i madhë është në fund të kanalit ku janë grilat mbrojtës për ndaljen e mbeturinave nga kanali për në liqe. Në fund të kanalit është i ndërtuar edhe një baj-pas shtesë me mjetet e Radoniqit.

Këtu duhet të ceket se kompania Radoniqi & Dukagjini-Ujitja nuk ka bërë asnjë investim gjatë vitit 2009 në mirëmbajtjen e kanalit derivues, liqe dhe digë, ku ky problem duhet të diskutohet në instancat më të larta ndërmjet 2 kompanive sepse janë shpenzime të cilat me vite i bartë kompania jonë. Kemi pasë kontakte të nivelit ndërkomunal Gjakovë-Deçan për mbrojtjen e lumit dhe kanalit.

Prodhimi i ujit

Gjatë muajit Janar – Dhjetor 2009. prodhimi i ujit ishte normal dhe i ka plotësuar kërkesat për furnizim me ujë, pa ndërprerje për të gjitha zonat furnizuese, me orarë të plotë 24^{h} pos në zonat më të larta gjatë stinës verore, ka pasur ndërprerje disa orëshe. Në vitin 2009 është prodhuar $15.162.287\text{ m}^3$ sasi kjo më e vogël në krahasim me vitin 2008 ku prodhimi ka qenë $17.047.774\text{ m}^3$. Nga të dhënat shihet se kemi një ulje të prodhimit vjetor të ujit rreth 2 mil. m^3 . Në këtë zvoqlim ka ndikuar edhe implementimi i programit mbi humbjet të dhuruar si Grant Qeveritar. Për këtë gjithsesi i jemi mirënjohës Qeverisë së Kosovës

Kualiteti i ujit

Uji i prodhuar vazhdimisht është nën kontroll dhe i plotëson standardet e kërkuara nga rregullorja për kualitetin e ujit të pijshëm, nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik. Gjatë kësaj periudhe kemi kontaktuar me Institutin e Shëndetit Publik, dega në Gjakovë nga dhe posedojmë konfirmimet me shkrim të analizave të ujit për pije të HS Radoniqi se i plotëson kriteret për ujë të pijshëm dhe se analizat bakteriologjike dhe fiziko-kimike janë NEGATIVE.

Në laboratorin e stacionit të filtrimit bëhen poashtu analizat interne për kontrollin e kualitetit të ujit ku analizat fiziko-kimike, dhe ate çdo 2 orë në 24 orë, pa ndërprerje, ndërsa ato bakteriologjike 1 herë në 24 orë si dhe marrja e mostrave në rrjetin furnizues nga pika më e afërta e deri te pika e fundit të rrjetit furnizues për analizimet bakteriologjike dhe fiziko kimike.



Mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellsit

Më 2009 numrit i defekteve ka qenë më i vogël në krahasim me viti paraprak, dhe vlen të theksohet se është bërë ndrimi i rrjetit Ø 63 - 110 mm PE në gjatësi prej 2283m. Arsyeja e këtij ndërimi i rrjetit është sepse kishte defekte të shpeshta dhe humbje të ujit në këtë pjesë të rrjetit.

Ekipi i mirëmbajtjes së rrjetit të ujësjellsit me angazhim të plotë dhe përkujdesje e bënë mirëmbajtjen e rrjetit dhe eliminimin e defekteve që paraqiten dhe lajmërohen. Këto defekte në rrjetë kryesisht janë defekte të natyrave dhe dimensioneve të ndryshme, kurse raste më të shpeshta janë defektet në rrjetin nga materiali i Azbest-Cementit.


Më konkretisht, punëtorët e mirëmbajtjes së rrjetit të ujësjellsit e kanë dëshmuar profesionalitetin e vetë në defektin e gypit magjstral Ø 800mm nga materiali GRP, në rrugën e UÇK, ku në kushte mjaft të vështira dhe thellësi prej 12m, duke punuar ditë dhe natë, 48 orë pandërprerje, arritën të rikthejnë në funksion të plotë furnizimin e gjithë regjionit me ujë të pijshëm. Me këtë rast, angazhimin e tyre maksimal e ka dhënë edhe stafi udhëheqës.

Numri i defekteve në të gjithë rrjetin e KRU "Radoniqit" në vitin 2009 ka qenë 1.487 në 3 Nj.P.

Tab e.paraqitjes së defekteve

Periudha	Nr def . Gjakovë	Nr. def. Rahovec	Nr.def. L.Bardh	Total
Jan-Dhjet 2009	724	328	435	1487

Jan-Dhjet 2009



Mirëmbajtja dhe ndërimi i ujëmatësve

Intervenimet në ujëmatësra bëhen atëherë kur konsumatorët ose inkasantët lajmërojnë raste të prishjeve (bllokim të ujëmatësve, dëmtime-thyerje e ndonjë dhëmbëzori, bllokimi nga zalli, si dhe ndërimi i xhamave si pasojë e çarje-plasaritjeve nga ngricat.

Në Gjakovë është intervenuar në 78 UM, Rahovec 106 UM, Lumbardh 142 UM. Këto intervenime nënkuptojnë ndërimin, pastrimin dhe/ose riparimin e ujëmatësve.

Paraqitjet e reja të konsumatorëve

Paraqitjet të reja bëhen nga kërkesat e personave fizik/juridik për kyqje si dhe nga paraqitjet e ekipit të kontrollës si paraqitje të detyrueshme. Më 2009 janë regjistruar 925 konsumator të rinjë. Në këtë rritje ka ndikuar edhe zgjerimi i rrjetës furnizuese për 3 fshatrat e Hasit, KK Gjakovës

Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit

Paraqitja tabelare e rrjetit të kanalizimit fekal:

Muaji	Pastrimi i rrjetit (m)	Pas-trimi i pusetave	Interv.me cistern
Gjakove	63.470	1.993	38
Rahovec	3.760	735	11
Totali	67.230	2728	49

Vlenë të ceket se ekipi i mirëmbajtjes së kanalizimit bënë edhe mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit atmosferik të qyteteve Gjakovë dhe Rahovec. Me këtë nënkuptohet pastrimi i gypave, puseta dhe i ujëmbledhsave rrugore edhe pse kjo nuk është aktivitet i biznesit tonë.

Kjo mbetet çështje që duhet të trajtohet në nivelin më të lartë politik ndër komunal.



Shërbimi për konsumatorë

Sektori për MKP me qëllim të harmonizimit sa më të mirë të punëve dhe detyrave të punës në mes të shërbimeve për konsumator në Kompani, në funksion të realizimit të objektivave kryesore të Kompanisë, dhe arritjes së standardeve shërbyese për konsumatorët e vet në nivelin e ndërmarrjeve të vendeve në rajon, përmes:

- Përmirësimin të sistemit të faturimit (avancimi i standardit të faturimit, modifikimi i formatit të faturave, adresimi i duhur i faturave për pagesë për rastet sociale.
- Përmirësimin të relacioneve me konsumatorë (Implementimi dhe arritja e funksionit të Kartës së Konsumatorit, përmirësimi i infrastrukturës së brendshme rregullore të shërbimeve për konsumator, ngritja e nivelit të komunikimit kompani-konsumator, ngritja e nivelit të përgjegjshmërisë dhe ndërgjegjësimi i konsumatorëve për pagesa dhe racionalizim të shpenzimit të ujit, ngritja e shkallës së azhuritetit të trajtimit dhe zgjidhjes së ankesave/kërkesave të konsumatorëve)
- Përmirësimi i relacioneve menaxhuese në Kompani (ngritja e nivelit të infrastrukturës telekomunikuese brenda kompanisë, ngritja e shkallës së azhuritetit në shkëmbimin e informacioneve - raporteve zyrtare në mes të punëtorëve, të synohet sigurimi i një Kompanie financiarisht të kamur, me mundësi që gjithnjë të aplikoj te rregullatori për tarifa të çmimeve të arsyeshme ashtu që të jenë të pagueshme edhe për shtresat e gjëra të popullsisë, njëkohësisht që të mbulojnë shpenzimet për sigurimin e shërbimeve

Arritjet

Kemi arritur të mbajmë në nivel faturimin, të ketë një inkasim të kënaqshëm perkunder standardit të konsumatorëve të rajonit me të cilën operon ndërmarrja, që gjithnjë e më tepër është duke pësuar ramje, e që ka rreflektur në permbushjen jo të kënaqshme të direktivave të marra në planifikimin e biznesit të kompanisë.

Veprimet për arritjen e arkëtimit

Në këto rezultate të arkëtimit ndikim me theks të veçantë kanë pas inicimi i procedurave për veprimin e shkyçjeve të konsumatorëve borxhlinj. Gjatë vitit 2009 janë bërë gjithsejt 1,236 shkyçje, si dhe 28 kyçje të reja.

Në drejtim të ngritjes së përgjigjësive për rritjen e arkëtimit rëndësi të veçantë i është kushtuar angazhimit për përmirësimin e punës së inkasantëve në raport me konsumatorë, sidomos mënyrën e komunikimit gjegjësisht sjelljes së tyre gjatë arkëtimit.

Me qëllim të ngritjes së shkallës së arkëtimit dhe zvogëlimit të keqpërdorimeve janë iniciuar dhe zbatuar procedurat për shkyçje të konsumatorëve të pandërgjegjshëm me borxhe të akumuluar, sipas procedurave të përcaktuara nga ZRRUM-i, po ashtu edhe të objekteve të braktitura dhe për identifikimin dhe anulimin e paraqitjeve të dyfishta. Procedurat e vërejtjeve për shkyçje ndaj konsumatorëve që nuk kanë paguar dhe masat e tjera sipas rregulloreve të ZRRUM-it janë zhvilluar gjithnjë kur kërkesat për shkyçje janë iniciuar nga sektori i faturimit.

Nga raportet e arkëtimit është vërejtur se probleme kryesore për ngecje në arkëtim paraqesin konsumatorët industrial. Ndaj një numri të konsumatorëve të kësaj kategorie janë bërë vërejtjet paraprakisht, për ata të cilët nuk kanë reaguuar është ngritë edhe padia gjyqësore. Problem paraqesin edhe ndërmarrjet që janë në privatizim. Nga AKM gjegjësisht tani nga AKP për ndërmarrjet që janë privatizuar deri më tani nuk është arkëtuar asnjë borxh i këtyre ndërmarrjeve. Përgjegjësve të Kompanisë u është sugjeruar të bëjnë presion të vazhdueshëm pran organeve kompetente.

Veprimet e përkujdesjes për konsumator

Përkujdesja për konsumatorë është zhvilluar në vazhdimësi si në pranimin e përditshëm të ankesave/ kërkesave me shkrim, telefonatave, apo kontaktimin e përditshëm me konsumatorëve, edhe në evidentimin , shqyrtimin, zgjidhjen dhe vendosjen lidhur me ankesat/ kërkesat e parashtruara të konsumatorëve. Parashtruesat e pranuar janë proceduar dhe vendosur në harmoni me dispozitat e përcaktuara me Ligjin Nr. 03/1-086, mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjetillësive, Kanalizimit dhe Mbeturive dhe rregulloret e ZRRUM-it, natyrisht shumica prej tyre janë të zgjidhura vetëm disa janë në procedurë (shiko raportin). Në fund të muajit Nëntor 2009 është bërë instalimi i modulit (software-it) të relacionit me konsumator, për menaxhimin e ankesave/kërkesave të konsumatorëve, në Zyrën e Relacioneve me Konsumator, është kërkuar që të instalohet edhe në shërbimet tjera përkatëse për konsumator, për të mundësuar koordinimi i plotë në shqyrtimin, zgjidhjen dhe vendosjen lidhur me ankesat/kërkesat. Për vitin 2009 nga Sektori për Konsumator janë shqyrtuar gjithsejt 470 Kërkesa /Ankesa të konsumatorëve - poz.372 / neg.98.\ Gjat vitit 2009 janë realizuar gjithsejt 28 programime të borgjeve.

Veprimet e raportimit në ZRRUM

Kontakte të rregullta janë mbajtur me Zyrën Rregullatore për Ujëra dhe Mbeturine, si me raportimin e të dhënave për relacionet e zhvilluara mujore Kompani Konsumator, po ashtu edhe me Këshillin Konsultativ të Konsumatorëve, ku nga ana e ana e shërbimit tonë i'u janë afruar të gjitha përgjigje dhe dokumentacionet e nevojshme të kërkuara. Kompania në procedurë të rregullt nga ZRRUM-i ka kërkuar dhe ka marrë pëlqimet për ekzekutimin e shkyçjeve Kolektiva, në të gjitha rastet e nevojshme. Është marrë pjesë aktive në të gjitha takimet e punës të organizuara nga ZRRUM-i për këshillimin lidhur me propozimet për ndryshime dhe plotësime të rregulloreve të ZRRUM-it, për Veprimtarinë e Shërbimeve të Ujësjetillësive dhe Kanalizimit të Ujërave të Zeza. Po ashtu kontakte përmes emalit apo direkt janë zhvilluar sa herë që është paraqitë nevojja për sqarime në interpretim të rregullave, për zgjidhjen e problemeve në raste të veçanta .

Kompania në procedurë të rregullt nga ZRRUM-i ka kërkuar dhe ka marrë pëlqimet për ekzekutimin e shkyçjeve Kolektiva, në të gjitha rastet e nevojshme. Është marrë pjesë aktive në të gjitha takimet e punës të organizuara nga ZRRUM-i për

këshillimin lidhur me propozimet për ndryshime dhe plotësime të rregulloreve të ZRRUM-it, për Veprimtarinë e Shërbimeve të Ujësjetillësive dhe Kanalizimit të Ujërave të Zeza. Po ashtu kontakte përmes emalit apo direkt janë zhvilluar sa herë që është paraqitë nevojja për sqarime në interpretim të rregullave, për zgjidhjen e problemeve të veçanta .

Veprimet e me media

Në funksion të ruajtjes dhe ngritjes së imazhit si dhe avancimit të kontakteve me konsumatorë, edhe gjatë kësaj periudhe ka pasur publikime të njoftimeve përmes mediave elektronike dhe të shkruara, takime me gazetar, intervista të drejtpërdrejta në radio dhe në TV lokale. Në funksion është ueb faqja. Gjithsejt gjat këtij viti janë bërë 18 publikime në media.

Veprimet për zvogëlimin e humbjeve

Me qëllim të zvogëlimit të humbjeve, bazuar në ankesat e konsumatorëve është kërkuar të shtohet kontrollimi i saktësisë së leximit të ujëmatësve si atyre kryesor dhe ujëmatësve individual. Leximet e gabuara apo mos leximi i qëllimit është ndeshkuar inkasanti nga ana e menaxhmentit. Është shtuar kontrolli në tërë zonat e përgjigjësive së secilit inkasant.

Veprimet për zvogëlimin e keqpërdorimeve

Me qëllim të zvogëlimit të keqpërdorimeve të shërbimeve të ujësjetillësive, Kryeshefi me lejinin e Bordit të Drejtorëve, i ka propozuar Sektorit të Arkëtimit të kërkojë nga lexuesit /arkëtuesi të identifikojnë dhe të raportojnë çdo rast të dyshimit për keqpërdorim të shërbimeve të ujësjetillësive, në regjionin e tij të leximit /arkëtimit, si mbështetje grupeve të kontrolles për zbulimin e kyçjeve ilegale nga konsumator të pandërgjegjshëm, në të kundërtën do të pasojë dënimi i vet inkasantëve.

Treguesit e performancës

Efikasiteti i stafit	8.01
Norma e e mbulimit të punës	1.02
Norma e punës	1.46
Shpenzimet operative/konsumator	5.47
Ndërprerjet mesatare/konsumator/ditë	0.00
Tarifat mesatare e vlerësuar/m ³	0.41

Treguesit e performancës arkëtimit (%)

Uji i pafaturuar	59
Përqindja e faturimit	99
Përqindja e konsumit të matur	87
Konsumator me ujëmatësa	94
Shkalla e inkasimit në total	69
Shkalla e inkasimit në amvisri	71
Shkalla e inkasimit në biznese	51
Shkalla e inkasimit në institucione	82

Pasqyrat e progresit financiar

Baza e përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitë në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit financiare. Pasqyrat Financiare janë përgatitë sipas parimit të kostos historike, ndërsa e modifikuar për paraqitjen e pronës, impianteve dhe pajisjeve në shumat e rivlerësuara. Këto pasqyra janë përgatitë nën pohimin se Kompania do të vazhdojë vijueshmërinë e sajë së paku edhe për 12 muaj.

Valuta

Këto pasqyra financiare të konsoliduar ajënë prezantuar në Euro, që është monedha funksionale ne Kompaninë tonë.

Prona, impiantet dhe pajisjet

Prona, impiantet dhe pajisjet janë bartur sipas rivlerësimit të bërë nga Kompania Grant Thornton si vlerësues të pavarure, minuse zhvlerësimi i akumuluar pasues. Efekti i rivlerësimit është vendosur në llogarinë e kapitalit-rezervat e rivlerësimit. E gjitha pozicionet e pronës, impianteve dhe pajisjeve janë paraqitë sipas kostos zbriture për zhvlerësimin e akumuluar. Kosto paraqet shpenzimet që i atribuohen direkt përvetësimit të zërave.

Toka nuk është e zhvlerësueshme . Zhvlerësimi në pajisjet tjera është bërë me metodën drejtvizore për të alokuar kostot e tyre siç vijon:

Ndërtesat me	5%
Pajisjet dhe makineria me	15%
Kompjuterët dhe pajisjet për zyre	20%

Llogarit e Arkëtueshme dhe kërkesat tjera

Llogarit e arkëtueshme në fillim njihen me vlerën e tyre reale dhe paraprakisht të matura me koston e amortizimit , minuse provizionimit për dëme.

Provizionimi për dëmet e arkëtueshmeve tregtare është vendosur aty ku ka dëshmi të mjaftueshme se Kompania nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat e borxheve si pas kushteve normale.

Vlera bartëse e llogarive të arkëtueshme zvogëlohet përmes një kontoje për lejim, shuma e humbjes njihet në pasqyrën e të ardhurave, kurse vlera e llogarive të arkëtueshmeve në bilancin e gjendjes paraqitet neto, duke ja zbritur totalit revizionimet.

Llogarit e Arkëtueshme dhe kërkesat tjera

Llogarit e arkëtueshme në fillim njihen me vlerën e tyre reale dhe paraprakisht të matura me koston e amortizimit , minuse provizionimit për dëme. Provizionimi për dëmet e arkëtueshmeve tregtare është vendosur aty ku ka dëshmi të mjaftueshme se Kompania nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat e borxheve si pas kushteve normale.

Vlera bartëse e llogarive të arkëtueshme zvogëlohet përmes një kontoje për lejim, shuma e humbjes njihet në pasqyrën e të ardhurave, kurse vlera e llogarive të arkëtueshmeve në bilancin e gjendjes paraqitet neto, duke ja zbritur totalit revizionimet.

Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë paranë në bankë dhe në dorë.

Stoqet

Vlera e stoqeve paraqitet me koston me të ulët apo me vlerën neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është çmimi shitës zvogëluar për koston e kompletimit, marketingut dhe shpërndarjes. Kosto parimisht është përcaktuar në bazë të çmimit mesatar.

Kapitali Aksionar

Kapitali aksionar është përcaktuar duke përdorur vlerën nominale të aksioneve që janë lëshuar.

Rezervat- Rezervat paraqesin ndryshimet ndërmjet kapitalit aksionar të regjistruar dhe vlerës neto të Aseteve siç është përcaktuar nga vlerësimi i pavarur në datën e inkorporimit të Kompanisë.

Llogarit e paguara dhe detyrimet tjera

Të pagueshmet tregtare dhe të tjera njihen në vlerën reale dhe më pas maten me koston e amortizimit duke përdorur metodën efektive të interesit. Kryesisht janë borxhet që kompania i ka ndaj furnitorëve , TVSH-se dhe të Hyrat e shtyera .

Njohja e të hyrave dhe shpenzimeve

Të hyrat njihen kur është mundësia e përfitimeve ekonomike lidhur me rrjedhën e transaksioneve të ndërmarrjes dhe kur shuma e të hyrave mund të matet besueshëm. Te hyrat njihen sipas parimit aktual, në momentin e fitimit. Shpenzimet operative njihen në pasqyrën e të ardhurave në kryerjen e shërbimit ose në datën e origjinës. Shpenzimet njihen sipas parimit aktual, në momentin e ndodhjes.

Situata financiare dhe Performanca financiare (viti 2009 duke krahasuar me B. Planin 2009)

Gjatë vitit 2009 Kompania ka afaruar me humbje, ku me të Hyrat e Arkëtuara nuk kemi mundur që ti mbulojmë Shpenzimet Operative . Humbja Ope-rative për vitin 2009 është ne vler prej - 11,756 €.

Shkalla e Inkasimit total në vitin 2009 është 69 % , ku nëse krahasohet me Biznes Planin e vitit 2009 kemi një rënie prej 3 %.

Beneficionet e punëtorëve

Kompania kontribuon për punëtorët e saj në planet e pensionimit si janë të përshkruara nga legjislacioni i sigurimit shoqëror miratuara nga UNMIKU.

Kursimeve Pensionale Kosvës(TKPK). Nuk ka ndonjë detyrim shtesë lidhur me këto plane dhe këto skema konsiderohen si plan i caktuar i kontributeve. Kompania nuk ka beneficione pas pensionimi për punëtorët e tyre.

PASQYRA E TE ARDHURAVE PER VITIN E PERFUNDUAR ME 31.12.2009				
	Shënimet	viti 2009	viti 2008	indeksi
1	Të hyrat nga shitja e ujit	2,541,624.27	2,461,808.83	1.03
2	Të hyrat tjera	74,676.34	86,682.46	0.86
	2.1 Zvogluar për lirimet në shitje			
	2.2 Shitjet e kthyera			
	2.3 Shitjet neto			
	2.4 Shpenzimet e mallrave të shitura			
	Fitimi bruto	2,616,300.61	2,548,491.29	1.03
3	Shpenzimet operative			
	3.1 Shpenzimet e pagave	-1,284,373.31	-1,155,354.25	0.90
	3.2 Shpenzimet e riparimeve dhe mirëmbajtjes	-36,016.63	-63,405.66	1.76
	3.3 Shpenzimet administrative dhe telefonit	-25,723.59	-28,401.04	1.10
	3.4 Shpenzimet e rrymës elektrike	-139,436.12	-130,483.65	0.94
	3.5 Shpenzimet e derivateve	-44,423.17	-59,821.09	1.35
	3.6 Shpenzimet e kemikaljeve	-40,384.84	-84,166.26	2.08
	3.7 Shpenzimet e marketingut	-10,581.92	-19,231.32	1.82
	3.8 Shpenzimet e borgjeve të këqija dhe të dyshimta	-665,905.48	-615,452.25	0.92
	3.9 Shpenzimet e zhvlerësimit	-753,557.46	-752,445.32	1.00
	3.10 Shpenzimet tjera operative	-207,188.62	-177,400.68	0.86
	Totali i shpezimeve operative	-3,207,600.14	-3,088,161.52	0.96
4	Të ardhurat operuese	3,216.05	4,861.30	0.66
	4.1 Të ardhura tjera			
	4.2 E ardhura nga dividenda			
	4.3 E ardhura nga interesi	3,216.05	4,861.30	0.66
5	Shpenzimet tjera			
	5.1 Shpenzimet e interesit			
	5.2 Shpenzimet nga tatimi në fitim			
	Fitimi / Humbja e vitit	-588,083.48	-534,808.93	0.91

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR PER VITIN E PERFUNDUAR ME 31.12.2009					
		Shënimet	2009	2008	indeksi
1	Pasuritë				
	1.1	Pasuritë jo qarkulluese	8,617,300	8,617,300	
	1.1.1	Toka		12,174,968	
	1.1.2	Ndërtesa		15,634,623	
	1.1.3	Inventari, pajisjet dhe makinat			
	1.1.4	Pasuritë e dhëna në lizing			
	1.1.5	Investimet afatgjate			
	1.1.6	Depozitat e afatizuara			
	Totali i pasurive jo qarkulluese			36,426,891	
	1.2	Pasurit qarkulluese			
	1.2.1	Stoqet neto	712,295	502,207	
	1.2.2	Llogarit e arkëtueshme	1,247,415	936,895	
	1.2.3	Kërkesat tjera	27,448	16,195	
	1.2.4	Parapagimet			
	1.2.5	Paraja dhe ekuivalentet e parasë	287,625	1,783,763	
	Totali i pasurive qarkulluese		2,274,625	1,783,753	
	Gjithsejt pasurit jo qarkulluese dhe qarkulluese		32,960,277	38,210,644	
2	Ekuiteti dhe rezervat				
	2.1	Kapitali i emituar	25,000	25,000	
	2.2	Rezervat e rivlerësimit	37,963,555	37,963,555	
	2.3	Fitimi / Humbja e akumuluar	-943,195	-408,386	
	2.4	Fitimi / Humbja e vitit	-588,083	-534,809	
	Totali i ekuitetit dhe rezervave		36,457,276	37,045,360	
3	Detyrimet				
	3.1	Detyrimet jo qarkulluese			
	3.1.1	Detyrimet afatgjata	124,431	83,976	
	3.1.2	Grantet e shtyera	232,363	6,102	
	Totali i detyrimeve jo qarkulluese		356,794	90,078	
	3.2	Detyrimet qarkulluese			
	3.2.1	Llogarit e pagueshme dhe të tjera	231,833	275,939	
	3.2.2	Tatimet e pagueshme	787,514	683,023	
	3.2.3	Shpenzimet aktuale	126,860	116,244	
	Totali i detyrimeve qarkulluese		1,146,207	1,075,206	
	Totali i detyrimeve jo qarkulluese dhe qarkulluese		1,503,001	1,165,284	
	Gjithsejt ekuiteti dhe detyrimet		37,960,277	38,210,644	

PASQYRA E RRJEDHJES SE ARKES PER VITIN E PERFUNDUAR ME 31.12.2009					
		Shënimet	2009	2008	indeksi
1	Rrjedhja e arkës nga aktivitetet operacionale				
	Fitimi / Humbja para tatimit		-588,083	-534,809	
	1.1	Parashtruar nga			
	1.1.1	Të hyrat nga grantet			
	1.1.2	Të hyrat financiare	-3,216	-4,861	
	1.1.3	Zhvlerësimet	753,557	754,445	
	1.1.4	Lejimet për borgjet e këqija	665,905	615,452	
	Fitimi operativ para ndryshimit në kapitalin punues		828,163	830,227	
	1.2	Ndryshimi në kapitalin punues			
	1.2.1	Stoqet	-210,088	61,661	
	1.2.2	Llog. e arkëtueshme dhe arkët. tjera	-987,679	-841,759	
	1.2.1	Detyrimet tjera tregëtare	337,717	40,736	
	Rrjedhja e arkës nga aktivitetet operacionale		-860,050	-739,361	
2	Rrjedhja e arkës nga aktivitetet investuese				
	2.1	Blerja e pasurive jo qarkulluese	-12,319	-15,259	
	2.2	Arkëtimi nga shitja e pasurive jo qarkulluese			
	2.3	Interesi i arkëtuar			
	2.4	Dividenda e pranuar			
	Rrjedhja e arkës nga aktivitetet investuese		-12,319	-15,259	
3	Rrjedhja e arkës nga aktivitetet financuese				
	3.1	Arkëtimet prej emitimit të aksioneve			
	3.2	Rezultati nga huamarrja			
	3.3	Pageasa e detyrimeve për lizingun			
	3.4	Dividenda e paguar			
	3.1	Të hyrat financiare	3,216	4,861	
	Rrjedhja e arkës nga aktivitetet financuese		3,216	4,861	
	Ndryshimet neto të parasë ekuivalentet e parasë		-40,990	80,469	
	Parat e gatshme në fillim të periudhës		328,456	247,987	
	Parat e gatshme në fund të periudhës		287,466	328,456	


PASQYRA E NDERRIMEVE NE EKUITET PER VITIN E PERFUNDUAR ME 31.12.2009

	Kapitali aksionar	Rivlerësimi I stoqeve	Rezervat e rivlerësimit	Fitimet/Humbjete mbajtura	Totali
Bilanci më 01.01.2007	25,000.00		37,454,172.63		37,479,172.63
Teprica nga rivlersimi					
Fitimi / Humbja për vitin 2007				-408,386.02	-408,386.02
Më 31.12.2007	25,000.00		37,454,172.63	-408,386.02	37,070,786.61
Më 01.01.2008	25,000.00		37,454,172.63	-408,386.02	37,070,786.61
Fitimi neto për periudhën					
Rivlerësimi I stoqeve 2008		509,382.41			509,382.41
Humbja për vitin 2008				-534,808.93	-534,808.93
Më 31.12.2008	25,000.00	509,382.41	37,454,172.63	-943,194.95	37,045,360.09
Më 01.01.2009	25,000.00	509,382.41	37,454,172.63	-943,194.95	37,045,360.09
Fitimi neto për periudhën					
Rivlerësimi I stoqeve 2009					

Siç shihet në treguesit e performancës të paraqitur më poshtë për periudhën Janar-Dhjetor 2009 reale dhe atyre të planifikuara në Biznes Plan për të njëjtën periudhë shihet se në total prej 15 treguesve 4 janë pozitive, 4 janë të njëjtë kurse 7 janë negativë. Shpenzimet Operative për vitin 2009 kanë një rënie prej 8.85% në krahasim me Biznes Planin e vitit 2009, meqenëse në Kompani kanë dalur disa

shpenzime të pa parashikuara siç janë: pagesa e borxheve të vjetra ndaj Administratës Tatimore të Kosovës në vlerë prej 50.000 €, pagesa e auditorëve të jashtëm dhe Kemikalet (pagesa që në të kaluarën janë bërë nga AKM-ja), pagesa e të cilave Kompania ka operuar me Humbje.

Treguesit e performances ne tregues relative per periudhen Janar-Dhjetor 2009 dhe BP. 2009



TREGUESIT KRYESOR TE PERFORMANCES TE KRAHASUARA ME 2008						
		Faturmi	Inkasimi	Shpenzime	Përqindja e inkasimit	Profiti operativ
		(Euro)	(Euro)	(Euro)	%	(Euro)
Janar	2009	184,987.00	111,856.00	137,577.00	60.00	-25,721.00
	2008	200,666.00	124,268.00	126,540.00	62.00	-2,272.00
Shkurt	2009	1,967,688.00	134,983.00	163,015.00	69.00	-28,032.00
	2008	204,733.00	120,367.00	135,355.00	59.00	-14,988.00
Mars	2009	259,150.00	123,636.00	149,271.00	48.00	-25,635.00
	2008	188,067.00	138,002.00	140,572.00	73.00	-2,570.00
Janar - Mars	2009	640,905.00	370,475.00	449,863.00	58.00	-79,388.00
	2008	593,466.00	382,637.00	402,467.00	64.00	-19,830.00
Prill	2009	215,002.00	153,826.00	147,244.00	72.00	6,582.00
	2008	217,001.00	140,056.00	125,089.00	65.00	14,967.00
Maj	2009	217,916.00	140,133.00	136,965.00	64.00	3,168.00
	2008	222,259.00	147,429.00	122,599.00	66.00	24,830.00
Qershor	2009	225,717.00	156,008.00	151,805.00	69.00	4,203.00
	2008	221,660.00	128,266.00	144,344.00	58.00	-16,078.00
Janar - Qershor	2009	1,299,540.00	820,442.00	885,877.00	63.00	-65,435.00
	2008	1,254,386.00	798,388.00	794,499.00	64.00	3,889.00
Korrik	2009	228,977.00	178,693.00	161,993.00	78.00	16,700.00
	2008	226,436.00	189,687.00	140,418.00	84.00	49,269.00
Gusht	2009	223,929.00	171,755.00	142,851.00	77.00	28,904.00
	2008	226,829.00	153,198.00	143,228.00	68.00	9,970.00
Shtator	2009	220,532.00	149,555.00	140,209.00	68.00	9,346.00
	2008	220,879.00	155,284.00	140,767.00	70.00	14,517.00
Janar - Shtator	2009	1,972,978.00	1,320,445.00	1,330,930.00	67.00	-10,485.00
	2008	1,928,530.00	1,296,557.00	1,218,912.00	67.00	77,645.00
Tetor	2009	235,256.00	140,358.00	148,766.00	60.00	-8,409.00
	2008	218,114.00	160,359.00	153,686.00	74.00	6,673.00
Nëntor	2009	214,662.00	155,095.00	149,644.00	72.00	5,451.00
	2008	211,408.00	144,435.00	171,970.00	68.00	-27,535.00
Dhjetor	2009	196,620.00	160,484.00	158,857.00	82.00	1,627.00
	2008	190,800.00	210,996.00	173,695.00	111.00	37,301.00
Janar - Djeter	2009	2,619,517.00	1,776,380.00	1,788,136.00	69.00	-11,756.00
	2008	2,548,852.00	1,812,346.00	1,718,263.00	71.00	94,084.00